

**AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"4SUN"shpk**

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Zoterimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Ortakët Themelues

1.1 Sot, më 20.01.2023 themeluesit, ka krijuar nje shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "4SUN" sh.p.k.

1.2 Themelues të shoqërise janë:

- **Shoqëria "RHG" shpk**, shoqëri e së drejtës shqiptare, me NIUS L91520027A, me adresë te ushtrimit të aktivitetit Rruga Pjeter Bogdani, Godine 1 Kateshe me zone kadastrale 8270, nr pasurie 3/52 Tiranë me përfaqësues ligjor Z.Geri Kuka identifikuar me nr.ID J30317070R
- **Shoqëria "ITE GROUP" shpk**, shoqëri e së drejtës shqiptare, me NUIS K11323001H, me adresë të ushtrimit të aktivitetit Rruga Dytesore, Autostrada Tirane-Dures, Km 5, Tiranë, me përfaqësues ligjor Z.Sokol Zotkaj, identifikuar me nr.ID F60507103W

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryeje aktivitetin e mëposhtëm:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore apo private te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te energjise jashte vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.



Neni 4

Selia

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Dytësore, Autostrada Tiranë – Durrës, Km 5, Zona Kadastrale 8320, Tiranë”

4.2 Asambleja e ortakëve mund të hapi ose të mbylli adresa dytësore, filiale, zyra përfaqësimi ose degë, zyra në Shqipëri ose jashtë.

Kreu II Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2(dy) kuota me vlerë prej 1,000,000 (një milion) lekë.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- “RHG” shpk, titullare i 1(një) kuotë me vlerë prej 670.000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë që përbën 67% të kapitalit të shoqërisë.
- “ITE GROUP” shpk, titullare e 1(një) kuotë me vlerë prej 330.000 (treqind e tridhjetë mijë) lekë që përbën 33% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e përgjithëshme e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila vëndos në të njëjtat kushte që kërkohen për modifikimin e statutit.

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi prek kapitalin e ortakëve në të njëjtën masë të pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre janë lirisht të transferueshme si në rastet më poshtë:

- në rastin e ortakut person fizik, për efekt të trashëgimisë në rast vdekje apo nëse transferohen të bashkeshortit apo pasardhësëve të ortakut;
- në rastin e ortakut person juridik nëse transferimi bëhet te ortakët e shoqërive pjesëmarrëse

(filialet) apo të lidhura me ortakun person juridik. Ky rast parashikon edhe mundësinë e operacioneve të mundshme të transformimit, bashkimit apo ndarjes apo blerjeve së shoqërive.

7.2 Në të gjitha rastet e tjera të transferimit të kuotave, i përket ortakëve e drejta e zgjedhjes dhe e preferencës.

7.3 Në cdo rast transferimi i kuotave të kapitalit nga ortaku duhet të bëhet me akt noterial.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8

Organi Vendimmarrës

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) ekzaminimin e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitur nga administratorët;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga Ligji, nga Statuti dhe cdo herë që asambleja bëhet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

9.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën që rezulton nga



Libri i Ortakëve ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike e certifikuar që u dërgohet të gjithë ortakëve. Njoftimi dërgohet të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

9.3 Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi tipin e asamblesë, vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës për thirrjen e parë dhe thirrjen e dytë.

9.4 Asambleja do të thirret dhe do të mbahet rregullisht edhe kur nuk janë respektuar formalitetet e njoftimit të saj, në momentin kur, janë prezent ortakët, të cilët përfaqësojnë kapitalin e plotë social.

9.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamble edhe nëpërmjet telekonferencë ose nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të jenë të identifikuar të gjithë të pjesëmarrësit dhe të jetë e mundur që të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në trajtimin e rendit të ditës si dhe të kenë mundësi të shqyrtojnë apo të marrin dokumentacionin dhe ta transmetojnë atë dhe në fund të marrin rregullisht pjesë në votim dhe në vendimarrje.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në çdo rast që merren vendime, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët e shoqërisë që zotërojnë të paktën tri të katërtat e votave të zotëruesve të kuotave të kapitalit.

10.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme për çdo vendim që do të marre do të vendose me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kuotave të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e listuara më poshtë dhe jo vetëm:

- a) Ndryshimi i statutit
- b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të regjistruar
- c) Shpërndarjen e fitimeve
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- e) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- f) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- g) Emërimin edhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h) Mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.2 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin e shoqërisë.



Neni 12

Administrimi

12.1 Administratorët kanë të drejtat dhe kompetencat për administrimin e përgjithshëm dhe të vecantë të Shoqërisë brenda limiteve që vendos Ligji, ky Statut dhe kompetencat që i përkasin asamblesë së ortakëve.

12.2 Administratori i Shoqërisë është: Gerti Zotkaj me Nr.ID I90121051H lindur dhe banues në Tiranë më 21.01.1989, i cili emërohet për një periudhë 5(pesë) vjecare;

Nënshkrimi i administratorit:

Gerti Zotkaj



Neni 13

Kompetencat e Administratorëve

Detyrimet e administratorëve:

- a) Të kyejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdesen për mirëmbajtjen korrekte të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojnë një sistem kontrolli mbi rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Të marr vendime të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e adresës/save të shoqërisë, duke përfshirë këtu dhe selinë qendrore;

Neni 14


Përgjegjësitë e Administratorit

14.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

14.2 Dëmet e shoqërisë që rrjedhin nga marrëveshjet të cilat nuk janë të miratuara nga asambleja i ngarkohen administratorit i cili ka bërë marrëveshjen;

14.3 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në



mjedis;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vleresojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Kreu IV

Viti financiar

Neni 15

Viti Financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të cdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 16

Raporti vjetor

16.1 Organi administrativ ose, sipas rastit, eksperti kontabël paraqet raportin financiar vjetor brenda 3(tre) muajve të vitit ushtrimor pasardhës.

16.2 Raporti përmban informacione mbi shpenzimet, të ardhurat dhe cdo lloj informacioni financiar tjetër mbi shoqërinë.

16.3 Asambleja miraton bilancin dhe llogaritë financiare të ushtrimit brenda 6 muajve të parë në vitin ushtrimor pasardhës.

Kreu V

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë me:

- a) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

Neni 18


Riorganizimi i shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe cilido ligj tjetër që aplikohet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akt themelimi dhe statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe palës së tretë, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21

Kopjet


Ky Dokument u redaktua në 2(dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Lexuar, miratuar, konfirmuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

“RHG” shpk

Z. Geri Kuka



“ITE GROUP” shpk

Z. Sokol Zotkaj

